


## MARRËVESHJE

Për themelimin e Akademisë (shkollës) së hendbollit në qytetin e Gjakovës



### Qëllimi i themelimit të Akademisë

Akademia e hendbollit do të ketë për qëllim angazhimin e sa më shumë të rinjve për të stërvitur sportin e hendbollit, zhvillimin psikomotrik të gjeneratave të reja ( kryesisht të moshave jo madhore).

### Palët e marrëveshjes

Federata e Hendbollit e Kosovës e përfaqësuar nga Kryetari z.Eugen Saraçini dhe

Komuna e Gjakovës e përfaqësuar nga Kryetari z.Ardian Gjini.

### Neni I

Federata e Hendbollit e Kosovës dhe Komuna e Gjakovës themelojnë Akademinë e Hendbollit në Prizren( në fazën e parë një vjeçare, si pilot projekt, me mundësi vazhdimi në mënyrë automatike edhe për vitet e tjera, duke pasur parasysh mundësit e zgjerimit të kërkesave dhe aktiviteteve, të cilat do të rishkruhen në aneks kontratë), e cila do të filloi nga puna prej 01.06.2018 deri më 31.05.2019 dhe do të ketë strukturë të organizuar.

- a) Një drejtor menaxhues
- b) Dy trajner për meshkuj
- c) Dy trajner për femra

### Neni II

Komuna e Gjakovës është e obliguar që para datës 01.05.2018 të caktoj vendin dhe kohën për zhvillimin e aktiviteteve të akademisë, për funksionalizimin e të gjitha punëve dhe realizimin e këtij pilotë projekti. KH Vëllaznimi do të jetë pjesë e projektit sipas marrëveshjes me FHK-në.

### Neni III

Komuna e Gjakovës merre përsipër transferin e mjeteve financiare në shumë prej 7,000.00 € në llogari bankare të FHK-së si më poshtë

- a) Kësti i parë, më 01.09.2018.
- b) Kësti i dytë, më 20.12.2018.
- c) Kësti i tretë, më 01.02.2019.

A. Gjini

J. Saraçini

#### Neni IV

Në bazë të paralogarive të FHK-së, projekti një vjeçar kushton rreth 15,000.00 €. FHK-ja merr obligimet për mbulimin e projektit në shumë prej 8.000.00€ (rekuizita, organizime, trajnime seminare etj.)

#### Neni V

FHK-ja është përgjegjëse për organizimin e mbarëvajtjes sipas planit operacional angazhimin e ekspertëve nga fusha e hendbollit. Po ashtu FHK merr përsipër furnizimin e akademisë me rekuizita sportive si dhe me mjete të tjera të nevojshme për funksionimin e Akademisë.

#### Neni VI

Komuna e Gjakovës, Drejtorja e Sportit dhe Drejtorja e arsimit, do të sigurojnë ambient të përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit të akademisë ( Shkolla apo palestër) që do të jetë me lokacion të qendër të qytetit.

#### Neni VII

Komuna e Prizrenit përmes kësaj kontrate(lejon) stafin e akademisë që në bashkëpunim me drejtorët dhe arsimtarët e edukatës fizike të shkollave fillore dhe të mesme që të hulumtoj dhe të zbuloj talente të reja, si dhe të inkurajoj nxënësit dhe prindërit e tyre për angazhim në këtë Akademi.

#### Neni VIII

FHK merr obligimin që të sajoi planin dhe programin e hollësishëm për funksionimin e akademisë, po ashtu FHK merr përsipër që ketë plan tija dorëzoi Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.

#### Neni IX

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, për secilën palë nga një kopje.

#### Neni X


Në rast të mos marrëveshjeve, palët për çdo paqartësi, apo kontest eventual, e autorizojnë Gjykatën Komunale të Prizrenit për zgjidhje.

Federata e Hendbollit e Kosovës

EUGEN SAKAJ, Kryetar



*Eugen Sakaj*



Komuna e Prizrenit

ARDIAN GJINI, Kryetar

*Arrian Gjini*